



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 10.03.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “AEG.NET” sh.p.k, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV AEG.NET”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
(Vendim nr. 23, datë 10.03.2026)
2. Pranimin e kërkesës së shoqërive “Tele.Co.Albania” sh.p.k. dhe “Tele.Co.Albania Fier” sh.p.k., duke kaluar të drejtat dhe detyrimet e autorizimit lëshuar për shoqërinë “Tele.Co.Albania” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Tele.Co.Albania”, tek shoqëria “Tele.Co.Albania Fier” sh.p.k., me afat vlefshmërie deri në datën 10.05.2027.
 - T’i heqë shoqërisë “Tele.Co.Albania” sh.p.k., autorizimin për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Tele.Co.Albania”
(Vendim nr. 24, datë 10.03.2026)
3. Pranimin e aplikimit të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve online, mbështetur në rrjet (IP) IPTV “Vodafone TV”, duke vendosur zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në.
(Vendim nr. 25, datë 10.03.2026)
4. Rinovimin e licencës së shoqërisë “My Music” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio My Music”, për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare.
(Vendim nr. 26 datë 10.03.2026)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 10 Mars 2026